
KONTRATE SHITBLERJE

E pjesëve të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

Sot me date me 09/10/ 2024 bazuar ne nenin 73/1/b te Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" - i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues te ligjit nr. 7850 dt. 29.7. 1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", nenshkruhet kjo " kontrate per shitje kuotash" si me poshte vijon, ndermjet:

- z. **Ilir Naci**, i biri i Muharremit, i datëlindjes 03.11.0971, lindur e banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaporten BR2566533 dhe nr personal ID H11103031L.

Këtu e më poshtë referuar si "Shitësi"

dhe

- z. **Nasry Awwad**, i biri i Ibrahimit, i datëlindjes 28.02.0986, lindur e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaporten BG6339961, dhe nr personal ID I60228147U


Këtu e më poshtë referuar si "Blerësi"

të dy së bashku këtu e më poshtë të referuar si "Palë" ose "Palët".

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë kontratë shitjeje të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

- a) Shitësi dhe Blerësi janë ortak të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k., me seli adresen Rruga Robert Shvarc, Njesi nr.5 me Zone Kadastrale 8260, Nr. Pasurie 6/758+2-N5., regjistruar si person juridik me në QKR më datë 09/09/2024 me NIPT M421090281.
- b) Shitësi është zoterues i një kuote me pjesëmarrje 90 % (nentedhjete përqind) të kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k. me vlerë nominale 90.000 (nentedhjete mijë) dhe Blerësi është zoterues i një kuote me pjesëmarrje 10 % (dhjete përqind) të kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k. me vlerë nominale 10,000 (dhjete mijë) leke.
- c) Palët kanë rënë dakord që, kundrejt plotësimit të kushteve që palët kanë përcaktuar në këtë kontratë, Shitësi t'i shesë Blerësit dhe Blerësi të blejë prej Shitësit 1 kuote kapitalit që perben në përqindje 40% te kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k.



Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin këtë kontratë për Shitjen e Kuotave të Kapitalit Themeltar të shoqërisë (këtej e tutje si "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja nga Shitësi 1 kuote të kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k. të zotëruara prej tij qe perben në përqindje 40 % e pjesëve të kapitalit te shoqerise dhe blerja nga Blerësi e këtyre e kuotes se perben në përqindje 40 % e pjesëve të kapitalit te shoqerise "Canadian Physio Center" sh.p.k. të zotëruara nga shitësi në bazë të kushteve të kësaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i shitjes

- 2.1 Palët kanë rënë dakord dhe kanë përcaktuar se çmimi i shitjes së kuotes së kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k qe perben në përqindje 40 % të kapitalit është me çmimin e tyre nominal, në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë.
- 2.2 Çmimi është i përcaktuar e i pranuar nga palët pa vërejtje.
- 2.3 Çmimi i shitblerjes së se kuotes se kapitalit qe perben 40 % (dyzet) të kapitalit i është paguar Shitësit tërësisht nga Blerësi dhe Shitësi deklaron se e ka arkëtuar atë dhe nuk ka asnjë pretendim ndaj Blerësit për çmimin.
- 2.4 Palët deklarojnë se pagesa e çmimit të plotë është bërë me transaksion bankar.

Neni 3


Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësit i kalon pronësia e kuotes të kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k. qe perben në përqindje 40 % të kapitalit dhe nga ky moment përbërja e ortakëve në shoqërinë "Canadian Physio Center" sh.p.k. dhe raportet e zotërimit të pjesëve të kapitalit të saj është si më poshtë:
- (i) z. Ilir Naci zotëron 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50 % të kapitalit te shoqerise;
 - (ii) z. Nasry Awwad zotëron 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50 % të kapitalit te shoqerise;

-
-
- 3.2 Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësit i takojnë të gjitha të drejtat e detyrimit që burojnë nga zotërimi i 50 % të kapitalit të shoqërisë "Canadian Physio Center" sh.p.k.

Neni 4 Garancitë

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se pjesët e kapitalit që ai blen janë të lira nga çdo barrë; nuk janë objekt i çfarëdo lloj veprimi juridik që ka si objekt pronësinë mbi to apo të drejta të tjera të çfarëdolloj të dhëna të tretëve veç blerësit; mbi pjesët e kapitalit që shiten dhe mbi shitësin nuk rëndon asnjë pengesë për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk ka pretendime nga të tretë për pronësinë e tyre. Pjesët e kapitalit që shiten nuk janë objekt i asnjë procesi administrativ, gjyqësor apo arbitrazhi dhe nuk ka asnjë vendim të asnjë organi shtetëror apo gjyqësor që mund të pengojë realizimin e kësaj kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se me nënshkrimin e kontratës së shitjes çmimi i mësipërm është i vetëm, përfundimtar dhe i pandryshueshëm dhe nuk do të ketë pretendime në të ardhmen as në lidhje me çmimin e shitjes së kuotave dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i tyre.
- 4.3 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se ai është përgjegjës e merr përsipër të shlyejë çdo detyrim, borxh dhe/ose pasiv që mund të rezultojë për të shkuarën, të tashmen apo në të ardhmen dhe që rrjedh nga aktiviteti i shoqërisë përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate apo zotërimi i kuotave të saj, duke qenë plotësisht i çliruar blerësit nga këto lloj detyrimesh.
- 4.4 Shitësi garanton Blerësin për konformitetin e akteve të shoqërisë e të kontratave të nënshkruar prej tij dhe nga shoqëria me të tretët deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate si dhe për ekzistencën dhe vijueshmërinë e të drejtave të fituara nga ato kontrata.
- 4.5 Shitësi garanton Blerësin për rregullsinë e veprimtarisë së shoqërisë, kundrejt të gjitha institucioneve dhe enteve shtetërore, personave të tretë, marrëdhëniet e kontraktimit (furnitorë, sipërmarrëse, shërbimit, kontrata etj,) si dhe të çdo lloj marrëdhënieje juridike, me apo pa kontratë, por që ka prodhuar efekte juridike për shoqërinë, me pasoja financiare dhe morale. Në rast të vërtetimit të parregullsive të një prej këtyre akteve, shitësi merr përsipër të shlyejë personalisht çdo detyrim apo dëm të mundshëm duke



qenë Blerësi i çliruar nga çfarëdo detyrimi për pagesë të këtyre detyrimeve dhe/ose dëmeve.

Neni 5

Data efektive

- 5.1 Kjo kontratë do të jetë efektive dhe e detyrueshme për palët nga data e nënshkrimit të saj.

Neni 6

Zgjidhja e Kontratës

- 6.1 Kontrata zgjidhet në rastet e parashikuara në dispozitat e saj.
6.2 Kontrata mund të zgjidhet në çdo kohë me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.

Neni 7

Forca Madhore

Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu siç përcaktohet nga ligji. Në këtë rast afatet e përcaktuara në kontratë do të pezullohen për gjatë gjithë kohëzgjatjes së forcës madhore dhe do të ri nisnin në momentin e përfundimit të saj.

Neni 8

Interpretimi i kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin atë.

Neni 9

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 9.1 Kjo kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.
9.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj marrëveshje midis palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
9.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Neni 10

Njoftimet

- 10.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim, me postë rekomande, në adresat e përshkruara në këtë Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt dhe në afatet e përcaktuara.
- 10.2 Në afatet e përcaktuara nga palët në këtë kontratë për lindjen e të drejtave e detyrimeve respektive nuk do të llogaritet koha e nevojshme për dorëzimin e njoftimeve nga shërbimi postar. Afati do të fillojë të llogaritet nga data e komunikimit të njoftimit nga shërbimi postar.
- 10.3 Në rast se ndonjëra prej palëve do të ndryshojë adresat e treguara në këtë kontratë, ajo duhet t'ia njoftojë këtë fakt palës tjetër menjëherë, në të kundërt, çdo njoftim i dërguar në adresën e treguar në këtë kontratë do të konsiderohet i kryer në adresën e treguar këtu. Secila prej palëve ruan të drejtën e shpërblimit të çdo dëmi të ardhur si rezultat i mos njoftimit të ndryshimeve të adresave të palëve kontraktore.

Neni 11

Hartimi i Kontratës

Kontrata u hartua në 3 (tre) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.

Neni 12


Hyrja në fuqi e Kontratës

- 12.1 Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo Kontratë fillojnë nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 12.2 Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu si dhe për trashëgimtarët e tyre.

PALËT

SHITËSI

Ilir Naci



BLERËSI

Nasry Awwad

